



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 24 mars 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L
I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Bojan Stojanović, Emrush Xhemajli, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkolli, Gani Geci dhe Zylfi Merxha.

Mungoi: Shkumbin Demaliaj, Agim Veliu, Ibrahim Selmanaj

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Nur Çeku dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **11.03.2009**
3. Miratimi i raportit nga takimi me përfaqësuesin e EULEX-it
4. Situata aktuale e sigurisë në Kosovë
5. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 11.03.2009

Procesverbali i datës 11.03. 2009 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i raportit nga takimi me përfaqësuesin e EULEX-it

Kryetari i Komisionit – tha, mbledhjen e fundit kemi pas një takim me përfaqësuesin e EULEX-it, stafi ka hartuar një draft raport dhe tani do të vendosim se a do ta dërgojmë këtë raport për kryesinë. Esenca është në raport por ka opinione që nuk janë cek, ka porosi të tjera që i shoh që janë me interes dhe duhet të përfshihen. Mendoj se bashkë me raportin duhet të njoftohet kryesia për opinionin e komisionit që e ka dhënë në atë takim.

Gani Geci – Ne ishim prezent atë ditë në takim kur z.Lukas na tha qartë se misioni i EULEX-it, është mision monitorues dhe jo mision diriguës, dhe për të gjitha çështjet e sigurisë në Kosovë kemi bashkëpunim të plotë dhe jemi në kontakt me organet tona pra, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me Ministrinë e FSK-së.

Kryetari i Komisionit – A pajtoheni me propozimin që ta rishikojmë edhe njëherë raportin dhe ti përfshijmë të gjitha çështjet më interesante për kompletimin e raportit. Çdo anëtarë ka te drejtë që të konsultohet dhe të jep koment tek stafi i komisionit, se si të involvohet ideja dhe të rrumbullakohet ky raport. Bojan Stojanovic ka reflektua në lidhje me krimin e organizuar, jo në baza etnike dhe ka kërkuar ndërprerjen sa më shpejtë të krimit. Kjo është e rëndësishme që raporti të pasqyrohet sa më gjerësisht.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim për raport.

4. Situata aktuale e sigurisë në Kosovë

Kryetari i Komisionit – Ne si Komision i Kuvendit për siguri në mënyrë permanente jemi marr me situatën e sigurisë në vend. Unë shoh premisa që po shkojmë kah përmirësimi, por natyrisht ka sfida ku kërkohet angazhimi i të gjithëve, pa përjashtim bashkëpunimi i gjithë mekanizmave tonë institucional dhe ndërkombëtarë. Ka zhvillime nga rekomandimet tona të bëra për Qeverinë në lidhje me marrjen e vendimeve politike. Vendim politik numërohet, ndalimi i ardhjes së zyrtarëve të shteteve që nuk i përfillin mekanizmat e vendit. Është pikë pozitive edhe shtrirja e EULEX-it me kapacitete të plota në tërë territorin e vendit. E arritur e patjetërsueshme është ngritja dhe trajnimi i FSK-së.

Emrush Xhemajli – Për mendimin tim situata e sigurisë është në përmirësim e sipër, nuk është vetëm vlerësim i yni, por vlerësim i të gjithëve. Rezultat i kësaj është reduktimi i forcave të KFOR-it, jo nga një shtet por nga disa shtete, gjë që tregon se situata në Kosovë tani është e qetë dhe po shkon drejtë përmirësimit. Shqetësim mbetet krimi i organizuar dhe veprimi i grupeve kriminale në veri. Kërkoj që në këtë drejtim të bëhet më shumë, sepse kjo do ta rregullonte rendin dhe qetësinë. Sa i përket policëve serb që nuk vijoje në punë gati që një vit dhe ende marrin paga nga buxheti i Kosovës, ne si komision duhet të thërrasim Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe tu rekomandojmë të ju ndërpriten pagat ose të kthehen në vendet e punës menjëherë.

Gani Geci – Unë pajtohem me parafolësin, se gjendja e sigurisë në vend është e qetë dhe ka tendenca për stabilizim. Unë e përgëzoj SHPK-në, konkretisht policinë kufitare për ndërmarrjen e hapave të rëndësishëm, për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjet e Republikës

së Kosovës. Ky vendim apo ndalje e zyrtarëve serb, ka lënë të kuptohet se Kosova është më e qetë. Sa i përket policëve serb që ende marrin paga, mendoj se duhet të ndërmarrim diçka në këtë drejtim në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, që të mos krijojmë situata jo të mira në Kosovë. Unë dua të cekim edhe një rast që ka ndodhur në një fshat të Kosovës, ku një fëmijë është kafshuar nga qentë endacak dhe mendoj se kjo është neglizhencë e ruajtësve të rendit por edhe neglizhencë e jona. Ne nuk kemi strategji për eliminimin e qenve endacak .

Melihate Termkollli – Për mua është shqetësim mënyra e shtrimit të kësaj çështje. Trajtimi i kësaj çështje kërkon seriozitet më të madh. Unë nuk kisha dashtë që Ad-hoc të trajtohet çështja e sigurisë në Kosovë, ose si një çështje abstrakte, ku mund të diskutosh çështjet e funksionimit dhe mosfunksionimit të strukturave paralele, e deri te rastet e dhunës fizike dhe individuale. Kur trajtohen këto çështje duhet të specifikohen apo tu jepet një kaheje, sepse nuk mund të diskutohet gjatë gjithë kohës çështja e sigurisë, pa dhënë asgjë konkrete. Mendoj dhe kërkoj, të mos devalvohet puna e komisionit dhe e institucioneve duke i trajtuar çështjet në këtë mënyrë, por ta bëjmë këtë në mënyrë më serioze.

Eqrem Kryeziu – Problemi është te obligimet e këtij komisioni. Ne në kryesi shpeshherë na kanë kritikuar që po dalim jashtë kompetencave, por duhet të sqarohet se vullneti i jonë është edhe i kryesisë së parlamentit, vullnet patriotik, shoqëror. Unë e çmoj këtë vullnet, por sa hyn kjo në dispozitat e ligjeve për të cilat ne jemi anëtarë. Ne si anëtarë të Kuvendit na interesojnë fenomenet paradoksale mu ndërpre. Do të isha shumë i kënaqur nëse institucionet tona janë duke dhënë shenja inkurajuese, por e përcjellin me zell të madh trendin e tendencave të shkeljes së ligjit.

Zylfi Merxha – Kur flasim për sigurinë në Kosovë, unë mendoj se po shkon në nivel të duhur. Si problem mendoj se është edhe, pritja e gjatë në radhë për marrjen e dokumentacionit personal. Si problem e konsideroj edhe marrjen e pagave nga policët serb, edhe pse refuzojnë të punojnë dhe mendoj se për këtë çështje, duhet të bisedojmë me udhëheqësit e policisë.

Zafir Berisha – Çështja e sigurisë u përmend disa herë në aspektin individual dhe në aspektin e përgjithshëm. Ne si komision, duhet të kërkojmë koordinimin e kësaj çështje. Siç përmendi z.Geci, për rastin e qenve endacak, si çështje e sigurisë në nivelin individual, unë mendoj se pushteti lokal duhet të merret me këtë. Unë ende nuk e kam të qartë se çka ka ndodh me ligjin për armët dhe mendoj se ne si komision duhet të dimë sepse është domosdoshmëri. Pastaj ligji për tubime publike, vërejtje që janë bërë gjithçka me qenë më të qarta. Zyrtarët e komisionit duhet t'ju kërkojnë institucioneve të caktuara, raporte në lidhje me këto ligje. Në diskutimin që u bë këtu u përmenden edhe problemet si p.sh: marrja e dokumentacionit, për këtë duhet të kërkohet ndonjë raport nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Bojan Stojanovic – Pajtohem me anëtarët e komisionit se situata e sigurisë është në lëkundje, por shpresoj që në të ardhmen do të bëhet më mirë. Në lidhje me policët serb, unë nuk e përkrasi mos vijimin e tyre në punë dhe që marrin paga edhe pse nuk shkojnë

në punë. Unë mendoj se Ministria e Punëve të brendshme, duhet ta shikojnë këtë çështje brenda një muaji dhe nëse ata pjesëtar dëshirojnë të punojnë le të kthehen dhe nëse jo atëherë le të shpallet një konkurs, sepse ka njerëz tjerë që dëshirojnë të punojnë. Një çështje tjetër që dua ta parashtoj, ka të bëjë me një kërkesë, sa i përket përdorimit të gjuhës në letërnjoftim, ne e kemi pyetur Ministrinë e Punëve të brendshme dhe ata na kanë thënë se kemi probleme buxhetore, por unë si kryetar i komisionit “zajedno” desha ta parashtoj këtu këtë çështje si njoftim sepse unë do ta vazhdoj ende këtë çështje.

Eqrem Kryeziu – Në Prizren sa i përket dokumentacionit, mund të ketë probleme thjeshtë formale me formularë por kjo është çështje teknike. E çmoj shumë tendencën që gjithçka të përmirësohet.

Gani Geci – Kam një propozim në lidhje me tabelat dhe rreth lëvizjes së automjeteve në Kosovë pa tabela ose me tabela të vjetra që nuk janë në përdorim as në Serbi. Ne kemi aprovua ligjin në Kosovë për dy nënshtetësi dhe unë kam një propozim konkret. Nëse qytetarët serb vendosin të jenë qytetarë të përhershëm atje, atëherë ata mund të shkojnë ti regjistrojnë automjetet e tyre dhe të vijnë në Kosovë të paguajnë taksa. Mirëpo, ne duhet ta heqim nga praktika lëvizjen e automjeteve pa tabela.

Kryetari i Komisionit – Ne për të gjitha këto, përveç qenve endacak, kemi dërguar rekomandime. Kemi kërkuar prej Qeverisë që të marrin vendime politike dhe për këtë jemi akuzuar se po i kalojmë kompetencat. Sa i përket pagave të policëve serb dy herë kemi bërë rekomandime për Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Unë mendoj se siguria në vend është mjaft e mirë. Situata e sigurisë mundet me qenë edhe më e mirë, mirëpo mungojnë kapacitetet analitike, akademike dhe teknike për shumë punë, por ne duhet ta gjejmë mënyrën se si ti zgjidhim.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Është një ftesë nga DCAF-i, për një trajnim në lidhje me qeverisjen e sektorit të sigurisë, që do të mbahet nga data 5-8 Prill. Në këtë trajnim janë ftuar të marrin pjesë 4 deputet dhe një anëtarë i stafit. Kam menduar që këtë delegacion ta kryesoj, zv.kryetari Bojan Stojanovic dhe 3 deputet të tjerë: Zylfi Merxha, Zafir Berisha dhe Agim Veliu.

Çështja tjetër ka të bëjë me planin e progresit të Komisionit Evropian, për tu realizuar sa më mirë kjo punë, desha ta caktojë një anëtarë të komisionit, pra mendoj se Emrush Xhemajli, do të merret me punët rreth këtij raporti të progresit.

Gjithashtu kemi një kërkesë prej sindikatës së shërbimit të zjarrfikësve, por kjo nuk është kompetencë e jona. A pajtoheni që këtë çështje ta adresojmë te organet e Qeverisë, apo te Ministria e Pushtetit Lokal.

Gani Geci – Sa i përket pikës të ndryshme unë kam një kërkesë nga bashkë atdhetarët që kanë probleme me vulat apostile. Kërkesë e imja është që të bëhet e mundshme që vulat ti marrin të gjithë në komunat e tyre.

Melihate Termkoll – Fillimisht departamenti për dhënie e vulave të apostilit ka qenë në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Ndërsa me formimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ky departament ka kaluar atje. Vulat e apostilit është shumë vështirë që të realizohen në çdo komunë, sepse vërtetësia e të dhënave bëhet përmes linjës zyrtare shtetërore. Është vështirë të bëhet një mekanizëm i veçantë për komunikim me të gjitha ambasadat për gjendjen civile të një personi. Për këtë mund të bëhet një menaxhim më i mirë i këtij departamenti, për të qenë më efikas.

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit